REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 351, Datë 12.11.2026

MBI

REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SH.P.K. TË LIDHUR ME CENTRALIN FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1793/9 prot., datë 11.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k., është mbajtëse e licencës s nr. 262, Seria P23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr.3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 111, datë 21.04.2026 ka vendosur të modifikoje licencën e kësaj shoqërie, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit (prej 50 MW).
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1793 prot., datë 05.06.2026, shoqëria ka kërkuar shtimin e kapacitetit të instaluar të impiantit me 210 MWh dhe në vijim të korrespondencës së zhvilluar me ERE-n, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2341 prot., datë 28.07.2026, shoqëria ka depozituar kërkesën dhe dokumentacionin për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike për parkun fotovoltaik 50 MW. Ndërkohë në datën 04.09.2026, ka njoftuar ERE-n, mbi pagesën e aplikimit që korrespondon me modifikimin e licencës.
- Me shkresën nr. 2341/1 prot., datë 14.10.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë të sqarojë në lidhje me kapacitetin e instaluar dhe kapacitetin energjetik të njësive të depozitimit objekt i aplikimit aktual, duke i evidentuar veçmas nga njësitë e depozitimit për të cilat është miratuar më parë modifikimi i licencës me vendimin nr. 111/2026, si dhe depozitimin e Formularit të Regjistrimit të plotësuar, së bashku me dokumentacionin plotësues.

- Shoqëria me shkresën me nr. 2341/2 prot., datë 30.10.2026 ka përcjellë informacion/dokumentacion plotësues. Në këto rrethana vlerësohet të vijohet me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë.
- Rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026 dhe shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin teknik dhe atë financiar, për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, me me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 105 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 210 MWh.
- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të këtij impianti në kuadër të licencës nr. 262, Seria P23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr.3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Shoqëria ka detyrimin që gjatë operimit të centralit fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), me kapacitet 210 MWh, të respektojë kufirin e fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin, si dhe kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.
- Shoqëria ka detyrimin që të mos tejkalojë fuqinë aktive totale të injektuar në rrjet prej 50 MW nga centrali fotovoltaik dhe impianti BESS, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.
- Në lidhje me pagesën e kryer nga shoqëria, që përkon me pagesën për modifikimin e licencës, vlerësohet që të rakordohet në vijim me strukturën e Financës, duke u marrë në konsideratë rregullimet në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s për vitin 2027.
- Shoqëria mund të operojë sipas përcaktimeve të kësaj dispozite për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit (pra për periudhën e mbetur). Për vijimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie përtej këtij afati, shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për pajisjen me licencën përkatëse, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Në lidhje me pagesën e kryer nga shoqëria, që përkon me pagesën për modifikimin e licencës, vlerësohet që të rakordohet në vijim me strukturën e Financës, duke u marrë në konsideratë rregullimet në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s për vitin 2027.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të regjistrojë impiantin e depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruar nga shoqëria "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 105 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 210 MWh, në kuadër të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet dhe lejohet të vijojë operimin për periudhën kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".
3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në Regjistrin përkatës të ERE-s dhe në Fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me rregullat në fuqi, përfshirë çdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI